# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458825**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Seria A - Lazio fiton në transfertë ndaj Venezia-s, Zaccagni dhe Noslin i japin kreun Gattuso-s |
| ADRESA | `https://www.syri.net/sport/917921/lazio-fiton-ne-transferte-ndaj-venezia-s-zaccagni-dhe-noslin-i-japin-kreun-gattuso-s/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 21:07:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 20:57:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5679618ff2ebb177faf9b8d1a297ffb646d0fa7cf19564db8fcee58bb0ef7f81` |
| TEKSTI | `a96ddda25beb51d16ddd8dc3b05a9aba2f41c772780da5730d0bc5b3bc218822` |
| PAMJA | `a17cd1557339ad45d47c1c45d16f0caee133ccf7d98b4ecad9dbcf8d22be5d77` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3fa27dbbc7abe002bf3160e2c61e6d7d210fd6770e2b5d0e55099728b243896b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `552a34f0419bb0f85ba237bcc1ccacbd9efdbebeb1d3d406ed195c7fa79d55c7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3fa27dbbc7abe002bf3160e2c61e6d7d210fd6770e2b5d0e55099728b243896b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


ENVER ROBELLI
Qëndrimi i Zagrebit dhe heshtja e Tiranës


NDRIÇIM KULLA
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane



# Lazio fiton në transfertë ndaj Venezia-s, Zaccagni dhe Noslin i japin kreun Gattuso-s

22:57, 19/09/2026

Lazio rikthehet tek fitorja në Serie A pas barazimit ndaj Milanit dhe mposht Venezian 2-0 në transfertë, në ndeshjen e vlefshme për javën e pestë të kampionatit. Skuadra e Gennaro Gattuso-s regjistron suksesin e katërt sezonal dhe ngjitet në krye të renditjes, me 13 pikë, së bashku me Interin dhe Romën.

Venezia pati mundësinë më të mirë për të kaluar në avantazh në pjesën e parë. Pas një pasimi të gabuar prapa nga Floriani, Mandas shkaktoi penallti duke rrëzuar Correian në zonë. Nga pika e bardhë u paraqit Yeboah, por portieri grek reagoi shkëlqyeshëm dhe priti goditjen e sulmuesit vendas.

Pjesa e parë u mbyll 0-0, me Lazion që pati vështirësi për të kontrolluar ndeshjen.

Në fillim të pjesës së dytë, këtë herë penalltia ishte në favor të Lazios. Në minutën e 51-të, kapiteni Mattia Zaccagni mori përsipër ekzekutimin dhe nuk gaboi, duke kaluar bardhekaltrit në avantazh.

Vetëm nëntë minuta më vonë, Lazio dyfishoi shifrat. Nuno Tavares dha asistin, ndërsa Tijjani Noslin e dërgoi topin në rrjetë për 2-0.

Në gjysmën e fundit të takimit, Venezia u përpoq të rikthehej në lojë dhe të ngushtonte diferencën, por pa sukses. Lazio menaxhoi avantazhin dhe mori tri pikët.

Me këtë fitore, Lazio shkon në kuotën e 13 pikëve dhe kryeson Serie A së bashku me Interin dhe Romën. Për Venezian, situata mbetet alarmante, pasi kjo ishte humbja e pestë radhazi dhe skuadra vazhdon të jetë me zero pikë.

© SYRI.net

Lexo edhe:


Barcelona përmbys Sevillan, Raphinha është thjesht fonemenal


Laporta sulmon Atletico-n për Julián Álvarez-in: E hoqën maskën

## më të lexuarat

Julian Alvarez rikuperohet në kohë, gati për derbin ndaj Real Madridit

'Dua Real Madridin në Champions'/ Intervista e Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën

VIDEO/ Gol i pazakontë nga Mesi, argjentinasi fiton trofeun e radhës kundër meksikanëve

Eric Garcia zgjedh favorit për 'Topin e Artë': E meriton Lamine Yamal

Zyrtare: Chelsea ndryshon pronësinë, Todd Boehly largohet nga klubi

Benfika e mposhti Milanin me 'rezervat', Amorim në alarm: Nuk jam në gjendjen e duhur mendore



"Kartoni i kuq, momenti vendimtar", Osmani tregon ku gaboi Laçi pas humbjes nga Dinamo

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

## Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

Harry Kane dhe "Topi i Artë": S'më pëlqen të flas për veten, 73 golat në sezon flasin vetë!

Arbër Hoxha largohet nga Dinamo Zagrebit, transferohet në Emiratet e Bashkuara Arabe

Messi do t'i japë lamtumirën Argjentinës në ndeshjen e 6 tetorit kundër Beninit

### TË NGJASHME

Daja pas fitores me Laçin: Vazhdimësia, elementi kryesor i mentalitetit fitues

Dortmundi ruan ecurinë perfekte, mposht Stuttgartin dhe ngjitet në krye

Dinamo nuk ndalet, mposht Laçin dhe feston fitoren e katërt radhazi

VIDEO/ Salah i bëhet makth Galatasaray-t, shënon tregolësh dhe feston me Muçin

Juventusi merr një goditje të rëndë, portieri dëmton ligamentin e kryqëzuar

Ahmataj analizon barazimin me Vorën: Terreni ndikoi, nuk bëmë ndeshjen tonë

Frankfurti dhe Freiburgu dhurojnë spektakël, por jo fitues, Bayerni i vetëm në krye



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.